Galeria Kombëtare e Arteve

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

NË TË TASHMEN
Fondi i Krijimtarisë 2026

Inaugurim 6 Nëntor 17:00-19:00
HangArt, Kinostudio, Tiranë

6–15 Nëntor 2026
Orari i hapjes: 14:00–19:00

JON AZIZAJ, KRISTANJA ÇENE, FATLUM DOÇI, GENTIAN DODA, ILIR KASO, SEAD KAZANXHIU, BESKIDA KRAJA, AURELA KUMANAKU, LORI LAKO, BLERINA MUÇA, MATILDA ODOBASHI, REMIJON PRONJA, LEONARD QYLAFI, ENZA RRIPAJ, ENDI SHANI, ABI SHEHU



Leonard Qylafi, *Shorts #7* (vepër në proces), 2026, Vaj në kanavacë, 95 × 80 cm

“NË TË TASHMEN – Fondi i Krijimtarisë 2026” është një ekspozitë kolektive që prezanton veprat e reja të realizuara nga 16 artistë shqiptarë, të përzgjedhur përmes një thirrjeje të hapur për mbështetjen e krijimtarisë artistike.

Në vitin 2026, me nismën e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Galeria Kombëtare e Arteve shpalli për herë të parë një thirrje të hapur për financimin e prodhimit të veprave të reja nga artistë shqiptarë, në kuadër të Fondit të Krijimtarisë. Përmes kësaj nisme, Galeria rimerr dhe forcon rolin e saj si institucion mbështetës i krijimtarisë bashkëkohore, duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e veprave të reja dhe në zhvillimin e praktikave artistike.

Nga thirrja u përzgjodhën 16 artistë, të ndarë në dy kategori: 10 artistë të afirmuar dhe 6 artistë të rinj dhe në zhvillim. Që prej korrikut 2026, artistët kanë punuar për realizimin e propozimeve të tyre. Për disa, mbështetja mundësoi vijimin e kërkimeve tashmë të konsoliduara; për të tjerë, hapjen e drejtimeve të reja të eksperimentimit.

NË TË TASHMEN ofron një panoramë të pjesshme, por të larmishme, të krijimtarisë aktuale në artin pamor shqiptar. Veprat prekin çështje si kërcënimet ndaj mjedisit, kujtesën personale dhe kolektive, migrimin, punën, identitetin dhe marrëdhënien e individit me realitetin përreth, ndërsa një pjesë e tyre vijojnë kërkime mbi imazhin, materialitetin dhe mundësitë shprehëse të mediumeve. Piktura, skulptura, fotografia, videoja, performanca dhe instalacioni bashkëjetojnë në një ekspozitë ku disa praktika thellojnë kërkime të mëparshme, ndërsa të tjera provojnë territore të reja.

Marrëdhënia e Galerisë Kombëtare të Arteve me artin e kohës së vet ka një histori të gjatë. Pas krijimit të Pinakotekës më 1949 dhe Galerisë Kombëtare të Arteve më 1954, institucioni mori një rol të dyfishtë: të ruante trashëgiminë artistike dhe, njëkohësisht, të krijonte hapësirën ku arti i së tashmes bëhej i dukshëm. Në sistemin e asaj kohe, kur tregu dhe galeritë private mungonin, ekspozimi, vlerësimi dhe koleksionimi zhvilloheshin brenda të njëjtit institucion. Ajo që sot lexojmë si histori e artit shqiptar ka hyrë, në shumë raste, fillimisht në Galeri si arti i së tashmes së vet. Pas vitit 1990, kjo marrëdhënie mori forma të reja, ndër të tjera përmes ekspozitave periodike të artit bashkëkohor.

NË TË TASHMEN shfaqet pikërisht në këtë interval: jo si rikthim i mekanizmave të mëparshëm, por si rimendim i rolit të institucionit në mbështetjen dhe prezantimin e artit të kohës së vet.

Ndërkohë, edhe fusha artistike ka ndryshuar rrënjësisht. Artistët shqiptarë studiojnë, jetojnë, punojnë dhe ekspozojnë mes vendeve, institucioneve dhe skenave të ndryshme. “Kombëtarja” nuk mund të kuptohet më si kufiri brenda të cilit arti duhet të prodhohet, por si shtrirja e një përgjegjësie: aftësia e institucionit për të ndjekur, mbështetur dhe njohur artistë që jetojnë mes botësh, duke ruajtur marrëdhënien me praktikat e tyre dhe duke i rikthyer ato në dialog me publikun dhe kujtesën kulturore shqiptare.

Veprat u përzgjodhën individualisht, por kur vendosen pranë njëra-tjetrës, prej tyre del një panoramë që nuk ishte e paracaktuar: jo një hartë shteruese e artit shqiptar bashkëkohor, por një prerje vertikale dhe e mprehtë e tij; një lloj termometri i një momenti.

Në të njëjtën hapësirë takohen artistë të lindur në fillim të viteve 1980, në vitet e fundit të socializmit, deri te një artist i lindur në vitin 2006, për të cilin ai sistem i përket tërësisht historisë dhe një kujtese të trashëguar. Mes këtyre dy skajeve shtrihet pothuajse i gjithë harku i transformimit shqiptar të katër dekadave të fundit: shuarja e një sistemi, tranzicioni i viteve 1990, migrimi, hapja dhe lindja e një brezi për të cilin lëvizja mes Shqipërisë dhe botës është pjesë normale e jetës dhe e praktikës artistike.

Kemi kështu në ekspozitë një brez pa brez përkufizues: jo një grup të bashkuar nga e njëjta përvojë historike, por disa histori që mbivendosen në të njëjtën të tashme. Edhe biografitë e tyre e bëjnë të dukshme këtë larmishmëri: praktikat lëvizin mes Shqipërisë dhe qyteteve të tjera europiane e më tej; disa artistë kanë kaluar përmes Bienales së Venecias, documenta-s, Manifesta-s, muzeve dhe rezidencave ndërkombëtare, ndërsa të tjerë sapo kanë filluar ta ndërtojnë këtë gjeografi. Një pjesë kanë krijuar vetë galeri, kolektive, hapësira të pavarura dhe platforma edukimi: një ekosistem që, edhe pse shpesh në kushte sfiduese, prodhon, organizon, eksperimenton dhe krijon rrjetet e veta.

Ndaj *NË TË TASHMEN* ka gjurmën e një Shqipërie bashkëkohore të vendosur në mes të një harte globale. Në të artikulohen territori dhe ekologjia, migrimi dhe kujtesa e së kaluarës së afërt, puna dhe transformimi i ekonomive, teknologjia, identiteti, trupi, koha dhe intimiteti.

Një bukë prej guri fsheh një thikë dhe hap historinë e kufirit, frikës dhe largimit. Një ritual mortor vajton për Vjosën dhe Nartën. Një kanoe e veshur me baltë bëhet shkollë. Në aeroport, koha matet nga një trup që shkruan dhe lodhet. Në Kombinat, "Made in Italy" qepet mbi stofin e prodhuar dikur në atë fabrikë dhe një etiketë e vogël kthehet në diagram të zhvendosjes së punës, origjinës dhe vlerës. Një tavolinë dhe një qiri rikthejnë netët kur "iknin dritat". Një mjet transporti dhe një depozitë artizanale ndjekin qarkun e prodhimit, përdorimit dhe riciklimit, duke bërë të dukshme një ekonomi që zakonisht mbetet në periferi të fokusit zyrtar.

Në vepra të tjera, e tashmja zhvendoset drejt perceptimit. Një gjurmë pasimazhi drite bëhet fotografi. Gjuha, si organ, kthehet në mbështetje fizike të trupit. Frymëmarrja e një instrumentisti përballet me ritmin e përshpejtuar të trafikut urban. Videot dixhitale, të shikuara me shpejtësi, transferohen në kohën e ngadaltë analoge të pikturës. Qytete imagjinare dhe figura humanoide shpërfytyrohen përmes vizatimit digjital. Forma të botës bimore shndërrohen në skulptura mes ornamentit dhe objektit autonom. Një lule vazhdon jetën e saj imagjinare përtej vdekjes biologjike. Afërsia njerëzore arrin deri në pikën ku kujdesi fillon të prekë autonominë personale.

NË TË TASHMEN bëhet kështu një lloj termometri i shoqërisë bashkëkohore përmes artit, duke pasqyruar tensione, përvoja dhe realitete të ndryshme që bashkëjetojnë në të njëjtën kohë. Të formuara nga e shkuara dhe nga pritshmëritë për të ardhmen, ato takohen dhe vendosen në dialog përmes veprave të ekspozitës.

Roli i Galerisë Kombëtare të Arteve është të krijojë hapësirën ku praktikat e ndryshme artistike prezantohen, kontekstualizohen dhe vendosen në dialog me njëra-tjetrën, duke nxjerrë në pah perspektiva të ndryshme mbi realitetin bashkëkohor dhe kontradiktat që e karakterizojnë atë. Roli i Ministrisë është të krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e kësaj veprimtarie, duke mbështetur prodhimin artistik dhe duke mundësuar prezantimin e tij në institucion, për publikun dhe në kuadër të zhvillimit të skenës artistike vendase. (Adela Demetja & Genti Gjikola)

Galeria Kombëtare e Arteve

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

IN THE PRESENT
Creativity Fund 2026

Opening: 6 November, 17:00–19:00
HangArt, Kinostudio, Tirana

6–15 November 2026
Opening hours: 14:00–19:00

JON AZIZAJ, KRISTANJA ÇENE, FATLUM DOÇI, GENTIAN DODA, ILIR KASO, SEAD KAZANXHIU, BESKIDA KRAJA, AURELA KUMANAKU, LORI LAKO, BLERINA MUÇA, MATILDA ODOBASHI, REMIJON PRONJA, LEONARD QYLAFI, ENZA RRIPAJ, ENDI SHANI, ABI SHEHU



BESKIDA KRAJA, *We have met before*, 2026, Still for Video, Sound, 16:9, 8 min

"IN THE PRESENT – Creativity Fund 2026" is a group exhibition presenting new works by 16 Albanian artists selected through an open call supporting artistic production.

In 2026, at the initiative of the Ministry of Tourism, Culture and Sport, the National Gallery of Arts launched, for the first time, an open call to fund the production of new works by Albanian artists through the Creativity Fund. Through this initiative, the Gallery resumes and strengthens its role as an institution supporting contemporary artistic practice, contributing directly to the realisation of new works and the development of artistic practices.

Sixteen artists were selected through the open call, divided into two categories: 10 established artists and 6 young and emerging artists. Since July 2026, the artists have been working towards the realisation of their proposals. For some, the support enabled the continuation of already established lines of research; for others, it opened new directions of experimentation.

IN THE PRESENT offers a partial but diverse view of current Albanian visual art. The works address issues including environmental threats, personal and collective memory, migration, labour, identity and the individual's relationship with the surrounding reality, while some continue investigations into the image, materiality and the expressive possibilities of different media. Painting, sculpture, photography, video, performance and installation coexist in an exhibition in which some practices deepen earlier lines of research, while others explore new territories.

The relationship between the National Gallery of Arts and the art of its own time has a long history. Following the establishment of the Pinacotheca in 1949 and the National Gallery of Arts in 1954, the institution assumed a dual role: to preserve the artistic heritage while, at the same time, creating the space in which the art of the present could become visible. Under the system of the time, when a private market and private galleries were absent, exhibition, evaluation and collecting took place within the same institution. Much of what we now read as the history of Albanian art first entered the Gallery simply as the art of its own present. After 1990, this relationship took new forms, including periodic exhibitions of contemporary art.

IN THE PRESENT appears precisely within this interval: not as a return to earlier mechanisms, but as a reconsideration of the institution's role in supporting and presenting the art of its own time.

Meanwhile, the artistic field itself has also changed radically. Albanian artists study, live, work and exhibit across different countries, institutions and artistic scenes. The "National" can no longer be understood as the boundary within which art must be produced, but rather as the extent of a responsibility: the institution's capacity to follow, support and recognise artists who live between worlds, maintaining a relationship with their practices and bringing them back into dialogue with the public and with Albanian cultural memory.

The works were selected individually, but when placed alongside one another, a panorama emerges that was not predetermined: not an exhaustive map of contemporary Albanian art, but a sharp vertical cross-section of it; a kind of thermometer of a moment.

Within the same space, artists born in the early 1980s, during the final years of socialism, encounter an artist born in 2006, for whom that system belongs entirely to history and inherited memory. Between these two points stretches almost the entire arc of Albania's transformation over the past four decades: the demise of one system, the transition of the 1990s, migration, opening up, and the emergence of a generation for whom movement between Albania and the wider world is a normal part of life and artistic practice.

The exhibition therefore brings together a generation without a defining generational experience: not a group united by the same historical experience, but several histories overlapping within the same present. Their biographies make this diversity equally visible: their practices move between Albania and other European cities and beyond; some artists have participated in the Venice Biennale, documenta and Manifesta, and have exhibited in museums and taken part in international residencies, while others have only begun to build this geography. Some have founded galleries, collectives, independent spaces and educational platforms themselves: an ecosystem that, despite often challenging conditions, produces, organises, experiments and creates its own networks.

IN THE PRESENT therefore bears the imprint of a contemporary Albania situated within a global map. Territory and ecology, migration and the memory of the recent past, labour and the transformation of economies, technology, identity, the body, time and intimacy are articulated within it.

A loaf of bread made of stone conceals a knife and opens onto a history of borders, fear and departure. A funerary ritual mourns the Vjosa and Narta. A canoe covered in mud becomes a school. At the airport, time is measured by a body that writes and grows tired. In Kombinat, "Made in Italy" is sewn onto fabric once produced in that same factory, and a small label becomes a diagram of the displacement of labour, origin and value. A table and a candle recall the nights when "the lights went out". A vehicle and an artisanal water tank trace the cycle of production, use and recycling, making visible an economy that usually remains at the margins of official attention.

In other works, the present shifts towards perception. The trace of a light afterimage becomes a photograph. The tongue, as an organ, becomes a physical support for the body. The breath of an instrumentalist confronts the accelerated rhythm of urban traffic. Digital videos, viewed at speed, are transferred into the slow analogue time of painting. Imaginary cities and humanoid figures are distorted through digital drawing. Forms from the plant world are transformed into sculptures poised between ornament and autonomous object. A flower continues its imaginary life beyond biological death. Human closeness reaches the point at which care begins to encroach upon personal autonomy.

IN THE PRESENT thus becomes a kind of thermometer of contemporary society through art, reflecting different tensions, experiences and realities that coexist at the same time. Shaped by the past and by expectations of the future, they meet and enter into dialogue through the works in the exhibition.

The role of the National Gallery of Arts is to create the space in which different artistic practices are presented, contextualised and brought into dialogue with one another, revealing different

perspectives on contemporary reality and the contradictions that characterise it. The role of the Ministry is to create the necessary conditions for this activity to take place, supporting artistic production and enabling its presentation within the institution and to the public, while contributing to the development of the Albanian art scene. (Adela Demetja & Genti Gjikola)

Contact: info@galeriakombetare.gov.al

www.galeriakombetare.al